



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 638, datë 16.12.2020

PËR
NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT NR.632, DATË 10.12.2020 TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 113 e 117 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 99 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, si dhe në informacionin e dërguar nga Gjykata e Apelit Shkodër, me email e datës 11.12.2020, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Ndryshimin e pikës 1, nëndarja “Gjykata e Apelit Shkodër”, paragrafi I, të Vendimit nr.632, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Gjyqtarja e skemës së delegimit e caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: Albion Shabaj, etj.; Akuza: Nenet 298/3, 139-25 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KRYETARE

NAUREDA LLAGAMI